



**AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË**  
**NJËSIA E KËRKIMIT PËR BIOTEKNOLOGJITË DHE GJENETIKËN**  
**FORUMI**

**“MBI GJENDJEN E KËRKIMIT SHKENCOR DHE PERSPEKTIVA NË BIOTEKNOLOGJI  
DHE GJENETIKË NË SHQIPËRI”**

### **Hyrje**

Njësia e kërkimit për Bioteknologjitë dhe Gjenetikën, e cila u ngrit kohët e fundit pranë Akademisë së Shkencave do të ketë fillimisht një rol koordinues për evidentimin e gjendjes së kërkimit në vendin tonë në këto fusha. Drejtuesit e kësaj Njësie kanë menduar të organizojnë Forumin Kombëtar ” Mbi gjendjen e kërkimit shkencor dhe perspektiva në Bioteknologji dhe Gjenetikë në Shqipëri” më 18 shtator 2020 në sallën “Aleks Buda” të Akademisë së Shkencave.

Krijimi i *Database* për institucionet që punojnë në këto fusha ka dhënë informacion të vlefshëm rreth grupeve kërkimore bashkëkohore me stafe të kualifikuara dhe projekte me synimin kryesor kërkimin në fushën e bioteknologjisë dhe gjenetikës, veçanërisht me qëllim aplikativ.

Forumi organizohet në kuadrin e Programit të Njesisë së re për kërkim të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës, si qendër pranë Akademisë së Shkencave dhe si grup *ad-hoc* duke përmbushur një nga misionet e Akademisë për rol koordinues në formimin e grupeve të punës të përhershme ose të përkohshme me rëndësi kombëtare në mbështetje të strategjive për kërkim e zhvillim, për organizimin e studimeve ndërdisiplinore me pjesëmarrjen e anëtarëve të saj dhe të studiuesve jashtë Akademisë.

Qëllimi i Forumit është të shkëmbehen mendime për:

- prioritetet në kërkimet shkencore bashkëkohore të zhvilluara deri më sot në Shqipëri në fushën e bioteknologjisë dhe gjenetikës;
- evidentimin e të gjitha potencialeve tona më të mira njerëzore dhe të infrastrukturës në këto fusha kërkimore shkencore dhe formimin e një rrjeti kombëtar për studime shkencore të koordinuara;
- për aftësimin e rrjetit për t’u përshtatur e për të konkurruar me sukses në tregun e dijes dhe kërkimit shkencor Evropian e Botëror;
- përfshirjen e drejtimeve bashkëkohore, që duhen për të zgjidhur problemet shqetësuese të ekonomisë, mbrojtjes së mjedisit, shëndetit etj., që shkenca dhe zbatimi i saj të funksionojnë si një proces i vetëm me elementet e duhur rregullatorë dhe ekuilibrat e brendshëm;

Ekspertët e fushave të ndryshme të bioteknologjisë dhe të gjenetikës, të ftuar në diskutimet në Forum do të evidentojnë kryesisht rëndësinë e bashkëpunimit të institucioneve të ndryshme shkencore dhe të universiteteve:

- për të harmonizuar tematikën e kërkimit shkencor dhe pjesëmarrje të përbashkët në Programet Kombëtare dhe projekte të tjera të fushës së bioteknologjisë dhe gjenetikës;
- për krijimin e konsorciumeve në vend midis grupeve kërkimore të institucioneve të ndryshme për pjesëmarrje më të përfaqësuar në projekte ndërkombëtare;
- për rritjen e eficiencës dhe vënien në funksionim të laboratorëve, ku janë investuar mjete financiare të konsiderueshme duke patur ekspertizën e specialistëve të fushës;
- për ngritjen e strukturave të reja bashkëkohore kërkimore shkencore në funksion të studimeve si dhe të bashkëpunimit në shkallë të gjerë midis specialistëve të fushave;
- për të gjetur mënyrat më efektive për të shkëmbyer përvojat pozitive midis grupeve të ndryshme kërkimore, që operojnë në të njëjtat drejtime shkencore, si dhe të atyre që punojnë në fusha të ngjashme e me lidhje midis tyre (p sh. impaktet mjedisore në teknologjitë ushqimore dhe farmaceutike, etj.);
- për të nxitur punime shkencore për doktoratura dhe punime të nivelit master, si dhe për të marrë përsipër zhvillimin e trajnimeve për studentët e specialistët e tjerë pranë Qendrave të specializuara dhe të kualifikuara në fushën e bioteknologjisë dhe gjenetikës në kuadrin e procesit mësimor, por edhe më gjerë.

Referuesit e ftuar në Forum do të jenë të përzgjedhur nga shtatë fusha të bioteknologjisë dhe gjenetikës:

- Bioteknologji Mjekësore
- Bioteknologji Farmaceutike
- Gjenetikë e Popullatave
- Bioteknologji Bimore
- Bioteknologji Zoo-Veterinare dhe Akuakulturë
- Bioteknologji Ushqimore
- Bioteknologji Mjedisore

Gjithashtu janë ftuar spikera nga drejtime të bioshkencave:

- Biomatematika
- Biofizika

Referuesit do të paraqesin shkurtimisht rezultatet e studimeve në institucione të ndryshme, që përfshihen në një fushë të caktuar, duke evidentuar problemet ekzistuese dhe veçanërisht perspektivën e studimeve në kuadrin e rrjeteve (NetWorks) të institucioneve bashkëpunuese sipas objektivave të sipërpërmendura.

Çdo paraqitje në formë Power Point do të zgjasë 15 min për grup, ndjekur nga pyetje nga auditori.

## **BORDI I BASHKËPUNËTORËVE TË NJËSISË BIOTEKNOLOGJI&GJENETIKË**

1. Akad. Ilija Mikerezi, FSHN, UT (Gjenetike) [imikerezi@yahoo.com](mailto:imikerezi@yahoo.com)
2. Akad. Efigjeni Kongjika, ASh (Bioteknologji Bimore) [kongjikaef@yahoo.com](mailto:kongjikaef@yahoo.com)
3. Prof. Ariola Bacu, FShN, UT (Biologji molekulare) [ariolabacu@yahoo.com](mailto:ariolabacu@yahoo.com)
4. Prof. Anila Hoda, UBT, (Bioteknologji zooveterinare & Biologji molekulare) [ahoda@ubt.edu.al](mailto:ahoda@ubt.edu.al)
5. Prof. As. Valbona Sota, FShN, UT, (Bioteknologji bimore) [bona\\_sota@yahoo.com](mailto:bona_sota@yahoo.com)
6. Prof. Alban Ibraliu, UBT (Bioteknologji & Biologji molekulare bujqësore) [albanibraliu@ubt.edu.al](mailto:albanibraliu@ubt.edu.al)
7. Prof. Magdalena Cara, UBT (Biologji molekulare), [magdacara@gmail.com](mailto:magdacara@gmail.com)
8. Prof. Anila Babameto, Universiteti i Mjekësisë, (Biologji molekulare humane) [laku62@yahoo.com](mailto:laku62@yahoo.com)
9. Akad.. Genc Sulcebe, Universiteti i Mjekësisë, (Imunogjenetikë Mjekësore, Gjenetikë e popullatave) [gencsulcebe@gmail.com](mailto:gencsulcebe@gmail.com)
10. Prof. As. Silva Bino, Instituti i Shëndetit Publik, Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (Biologji molekulare humane per semundjet infektive) [silviabino@gmail.com](mailto:silviabino@gmail.com)
11. Prof. Ledjan Malaj, Universiteti i Mjekësisë, Departamenti i Farmacisë (Bioteknologji farmaceutike) [ledjan.malaj@umed.edu.al](mailto:ledjan.malaj@umed.edu.al); [ledjan.malaj@gmail.com](mailto:ledjan.malaj@gmail.com)
12. Prof. Vlash Mara, Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit, UBT (Bioteknologji ushqimore) [vlashmara@yahoo.com](mailto:vlashmara@yahoo.com)
13. Dr. Jonida Boçi, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (Biologji molekulare), [jonaboci@yahoo.com](mailto:jonaboci@yahoo.com)
14. Prof. As. Luljeta Pinguli, FShN, UT, (Bioteknologji ushqimore) [luljetinguli@yahoo.com](mailto:luljetinguli@yahoo.com)
15. Prof. As. Lila Shundi, Instituti i Shëndetit Publik, Laboratori i Biologjisë Molekulare, Departamenti i Laboratorëve të Referencës (Gjenetikë molekulare), [lilashundi@yahoo.com](mailto:lilashundi@yahoo.com)
16. Dr. Elektra Papakosta, Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqësore, Vlore (Bioteknologji bimore), [elektrakrist@yahoo.com](mailto:elektrakrist@yahoo.com)

# PROGRAMI

**08.30 – 09.00**      **Regjistrimi i pjesëmarrësve**

**09.00 – 09.15**      **Përshëndetje**

Akademik Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Akademik Ilija Mikerezi, Akademike Efigjeni Kongjika, Bashkëdrejtues të Njesisë së Kërkimit në Bioteknologji/Gjenetikë

## SESIONI 1

### Bioteknologji Mjekësore dhe Farmaceutike, Gjenetika e Popullatave

Moderatorë: Akad. Ilija Mikerezi, Prof. Anila Babameto – Laku, Akad. Genc Sulçebe, Prof. Ledjan Malaj, Prof. As. Silva Bino

#### Bioteknologji Mjekësore

**09.15 – 09.30**      "Zhvillimi i diagnostikës molekulare dhe i gjenetikës mjekësore në Shqipëri si dhe sfidat për të ardhmen",

Anila Babameto – Laku (UMT), Lila Shundi (ISHP), Anila Mitre (UT).

**09.30 – 09.45**      "Zbulimi molekular dhe sekuencimi gjenetik gjatë pandemive dhe hetimit të epidemive - arritje, sfida dhe perspektiva në Shqipëri",  
Silva Bino, Iris Hasibra, Majlinda Kota, Lila Shundi, Artan Bego (ISHP).

**09.45 – 10.00**      "Aplikimet e teknikave të gjenetikës molekulare në mjekësinë transfuzive: progresi dhe sfidat",

Irena Qendro (UMT), Merita Xhetani (UT).

**10.15 – 10.30**      "Roli i Imunogjenetikës në studimin e lidhjeve gjenetike midis popullatave si dhe për realizimin e transplanteve në Shqipëri",

Genc Sulçebe, Erkena Shyti, Jonila Dashi, Valentina Semanaj, Margarita Kurti-Prifti, Zamira Ylli (UMT).

#### Gjenetika e Popullatave

**10.30 – 10.45**      "Zhvillime dhe perspektiva të studimeve në gjenetikën e popullatave",

Ilija Mikerezi (UT), Grigor Zoraqi (MSHMS), Genc Sulçebe (UMT), Anila Hoda (UBT).

### Bioteknologji Farmaceutike

- 10.45 – 10.55** “Barnat biologjike në Shqipëri, roli i teknologjisë farmaceutike dhe i sistemit rregullator në zhvillimin e tyre”,  
Ledjan Malaj, Brunilda Myftari (UMT)
- 10.55 – 11.05** “Vlerësimi kimik dhe i aktivitetit biologjik të disa përbërësve kimikë në bimë mjekësore dhe aromatike; aktualiteti dhe perspektiva e aplikimit të tyre”,  
Vilma Papajani (Toska), Erjon Troja, Entela Haloci (UMT), Entela Hodaj (UBT), Aurel Nuro, Valbona Sota (UT).
- 11.05 – 11.15** “Gjenetika dhe Bioteknologjia e lidhur me aktivitetin fizik, sportin dhe shëndetin”,  
Dhurata Bozo (UST)

**11.15 – 11.30**

***Pushim Kafeje***

## **SESIONI 2**

### Bioteknologji Bimore dhe Zooveterinare

**Moderatorë: Akad. Efigjeni Kongjika, Prof. Anila Hoda, Prof. Ariola Bacu, Prof. Alban Ibraliu**

#### Bioteknologji Bimore

- 11.30 – 11.45** “Metoda inovative të bioteknologjisë bimore për prodhimin e fidanëve të certifikuar të kultivarëve autoktonë të drurëve frutorë dhe të hardhive – nevojë urgjente për tregun e frutikulturës”,  
Efigjeni Kongjika (ASH), Valbona Sota (UT), Elektra Papakosta (QTTB, Vlorë).
- 11.45 – 12.00** “Risitë e përdorimit të kulturave *in vitro* në përmirësimin gjenetik të bimëve”,  
Alban Ibraliu, Petrit Rama, Edlira Kukali, Dorianë Xhulaj (UBT).
- 12.00 – 12.15** “Teknikat molekulare dhe citogjenetike në shërbim të detektimit të konstrukteve transgjenike, polimorfizmave subpopullative, dhe kontrollit të shprehjes së gjeneve tek bimët”,  
Ariola Bacu, Zhaneta Zeka, Rexhep Shkurti, Arjana Kraja (UT), Aulona Veizi (QTTB, Vlorë).
- 12.15 – 12.30** “Diagnoza molekulare e patogjenëve bimore në shëndetin e bimëve si dhe në seleksionimin klonal dhe fitosanitar.”,  
Magdalena Cara (UBT), Ariola Bacu (UT), Melaize Yzeiraj (QTTB, Vlorë).

### Bioteknologji Zoo-Veterinare dhe Akuakulturë

- 12.30 – 12.45 “Bioteknologjia, si dhe cilësia dhe siguria e produkteve blegtorale primare”,  
Anila Hoda, Enkelejda Sallaku, Myqerem Tafaj (UBT).
- 12.45 – 13.00 “Integrimi i metodave *in situ* dhe *ex situ* të konservimit të burimeve gjenetike shtazore në programet e ruajtjes/përmirësimit gjenetik dhe kërkimin shkencor”,  
Lumturi Papa, Kristaq Kume (UBT).
- 13.00 – 13.15 “Pandemitë në këndvështrimin e *filozofisë një shëndet* dhe kontributi i shkencave veterinare”,  
Xhelil Koleci (UBT), Jonida Boçi (ISUV).
- 13.15- 13.30 “Gjendja dhe e ardhmja e aplikimit të bioteknologjisë në akuakulturë”  
Rigerta Sadikaj (UT), Vladimir Spaho, Valbona Kolaneci (UBT), Dritan Arapi (UT)
- 13.30 – 14.00 **KATERING**

## SESIONI 3

### Bioteknologji Ushqimore dhe Mjedisore

#### Bioteknologji Ushqimore

Moderatorë: Prof. Rozana Troja, Prof. Vlash Mara, Prof. Renata Kongoli, Prof. As. Laura Shabani

- 14.00 – 14.15 “Studime bashkëkohore në fushën e bioteknologjisë ushqimore: Veprimi i antimikrobialëve natyrorë dhe atyre me origjinë bakteriale për të rritur sigurinë dhe cilësinë e produkteve ushqimore me përdorim të gjerë”,  
Rozana Troja, Laura Shabani, Luljeta Pinguli, Eltion Dharmo (UT).
- 14.15 – 14.30 “Studime për prodhimin dhe përdorimin e enzimave dhe qelizave të imobilizuara në industrinë ushqimore”,  
Luljeta Pinguli (UT), Vlash Mara (UBT), Vilma Gurazi (UT, UBT).
- 14.30 – 14.45 “Krijimi i koleksionit të kulturave të pastërta të mikroorganizmave industriale dhe përdorimi i starteve me shtame të seleksionuar me interes në industrinë e fermentimeve të drejtuara”,  
Laura Shabani, Rustem Zenelaj (UT), Kristaq Sini (UBT).
- 14.45 – 15.00 Zbulimi i gjenit target aceA të shtameve *Salmonella* spp. në produktet me origjinë shtazore, përmes Real Time – PCR”,  
Renis Maçi (ISUV), Fatmira Shehu, Bisena Bijo (UBT).
- 15.00 – 15.15 “Perspektiva e sistemeve të ushqimit dhe roli i bioteknologjisë në

**diversifikimin e tyre për një prodhim të qëndrueshëm dhe dieta të shëndetshme”,**

Renata Kongoli, Anila Kopali, Ariola Morina, Enkelejda Berberi, Migena Hoxha (UBT).

### **Bioteknologji Mjedisore**

**Moderatorë: Akad. Ilirjan Malollari, Prof. Klementina Puto, Prof. Aida Bani**

- 15.15 – 15.30**      **"Trajtimi kompleks i mbetjeve ligno-celulozike agro-pyjore dhe i manureve organike me anë të metodave të biodixhestionit (zbërthimit) në bioreaktorët anaerobikë, për përfitim të energjisë së rinovueshme",**  
Ilirjan Malollari, Luljeta Pinguli, Dhurata Premti, Anisa Dhroso, Xhaklina Cani (UT), Sami Makolli (UBT, Prishtinë).
- 15.30 – 15.45**      **"Transformimi biologjik i shkarkimeve industriale nga industritë ushqimore, për përfitim të biokarburanteve dhe disa kimikateve të dobishme: Rasti i prodhimit të bioetanolit nga hirat e djathit",**  
Vjola Bakillari, Ilirjan Malollari, Hasime Manaj, Klementina Puto, Etleva Hamzaraj (UT).
- 15.45 – 16.00**      **"Phytomining", bioteknologjia për rehabilitimin e tokës dhe rikuperimin e metaleve si alternativë bujqësore në peizazhet ultramafike Shqiptare. Rasti i nikelit",**  
Aida Bani, Guillaume Echevarria, Seit Shallari, Sulejman Sulce (UT).

## **SESIONI 4**

### **Biomatematikë dhe Biofizikë**

**Moderatorë: Prof. Marenglen Spiro, Dr. Erilda Gjini**

- 16.00 – 16.15**      **"Ide dhe resurse për zhvillimin e biomatematikës dhe biologjisë kompjutacionale në Shqipëri",**  
Erida Gjini (Instituti Gulbenkian, Portugali), Blerina Sinimeri (Universiteti Lion, INRIA)
- 16.15 – 16.30**      **"Zhvillimet në fushën e biofizikës dhe perspektivat në rrugën e studimeve e zbatimeve të bioteknologjisë në vendin tonë",**  
Marenglen Spiro (Universiteti Marin Barleti), Teodor Karaja, Emil Xhuvani (UT), Albana Topi (GSI-Helmholtz Center, Darmstadt, Gjermani)

**16.30 – 16.50**      **Seancë diskutimi**

**16.50 – 17.00**      **Përfundime të Forumit.**